



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Nr 61P Prot

Kuçovë, më 13/2 /2019

KONTRATË

OBJEKTI I KONTRATËS

“ SHËRBIMI I PASTRIMIT, MBLEDHJEN DHE TRANSPORTIMIN E MBETJEVE
URBANE NË BASHKINË KUÇOVË ”


2019

Autoriteti Kontraktor

BASHKIA KUÇOVË

KRYETARI

Selfo KAPLLANI



Kontraktuesi

Viola Green shpk

ADMINISTRATOR

Marsel SHEGA



E lidhur sot, më datë 13 / 02 / 2019 në bazë të nenit 850 dhe në vazhdim të Kodit Civil, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë , e përfaqësuar nga Kryetari **Z. Selfo KAPLLANI**, më poshtë i quajtur “Autoriteti Kontraktor” .

dhe “ **VIOLA GREEN** ” shpk

Përfaqësuar nga **Z. Marsel SHEGA** , administrator i shoqërisë “ Viola Green” me Nr **NIPT-i L 51928004 K** me adresë Njësia bashkiake nr 2, bulevardi Zhan D’ark, pallati Wonder, kati 2 Tiranë , për sa më poshtë i quajtur “ Kontraktues ”.

Kontrata do të mbikqyret nga Supervizori Z. Ndriçim PIRJA

* * * * *

Kapitulli I

DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Ligji Nr.7850,datë 29.07.1994. “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” , i ndryshuar.

Ligji Nr.9643 date 20.11.2006 “ Për Prokurimin Publik ”, i ndryshuar .

Kjo Kontratë përpilohet sipas kushteve të Përgjithëshme të Kontratës e të dhënave për zbatimin e punimeve/shërbimit. **Dokumentat e tenderit, specifikimet teknike të shërbimeve, preventivat, si dhe oferta e fituesit janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.**

Neni 1:

Objekti i kontratës

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është : “ **Shërbimi i pastrimit, mbledhjen dhe transportimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë** ” për 4 (katër) vite , i cili do të kryhet bazuar në zërat e punës të përcaktuar në preventiv , (analizave të kostos) si dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe metodologjinë e punës .

Neni 2:

Çmimi i Kontratës


2.1 Autoriteti Kontraktor i detyrohet t’i paguaje Kontraktuesit per realizimin e objektit te kesaj Kontrate, nje vlere prej : **93 948 678** (nëntëdhjetë e tre milion e nëntëqind e dyzetë mijë e

Viola Green
Nis: L 51928004 K
TIRANË - ALBANIA

gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh ose 112,738,413.6 (njëqind e dymbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e trembëdhjetë pikë gjashtë) lekë me tvsh, e përcaktuar nga Kontraktuesi në tenderin për sipërmarrjen e punimeve/shërbimeve me realizimin e të gjithë punimeve që përfshihen në këtë Kontratë (preventivi). Si burim financimi do të shërbejnë fondet e akorduara nga të ardhurat lokale dhe granti i buxhetit të shtetit .

PREVENTIVI FITUES

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi/ njesi	Dite pune/ vit	Vlera
.	NJ.A. Qyteti Kucove + Lumas					
.	Fshirja me fshese dore e rrugeve dhe shesheve	m ²	167 000	0.0981697296606786	312	5,115,035.59
.	Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier)	cope	280	85.02849143	312	7,428,089.1
.	Sherbimi i pastrimit ne WC-te publike te qytetit	“	4	907.05054	312	1,131,999.07
.	Lagje rruge e sheshe me mjet teknologjik	m ²	73 000	0.154036195	220	2,473,821.29
.	Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike e pikat e grumbullimit te mbeturinave	dite	312	5260.5432	312	1,641,289.48
	Shuma I					
I.	NJ.A. Kozare					
.	Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier)	cope	95	115.2427621	156	1,707,897.73
.	Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike e pikat e grumbullimit te mbeturinave	dite	104	7701.0824	104	800,912.57
	Shuma II					
II.	NJ. A. Perondi (llogaritja prill 2019 - prill 2022)					
.	Fshirja me fshese dore e rrugeve dhe shesheve	m ²	29 800	0.136835108	312	1,272,238.10
.	Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier)	cope	95	112.3336674	156	1,664,784.95
.	Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike e pikat e grumbullimit te mbeturinave	dite	104	7555.7944	104	785,802.62
.	Larja e konteniereve metalike	cope	95	77.19406933	72	528,007.43
	Shuma III					4,250,833.10
	Shuma totale (I+II+III)					4,250,833.10
	TVSH 20%					850,166.62
	Shuma totale					5,100,999.72



Neni 3:

Afati kryerjes së shërbimit

3.1 Afati maksimal i kryerjes së punimeve të objektit të sipërpërmendur është 4 (katër) vjet ose **1460 ditë** kalendarike, të llogaritura nga data e nënshkrimit të Kontratës.

Punimet e shërbimit do të fillojnë më datë **15 / 02 / 2019**, sapo të kalojë periudha 2 (dy) ditore e trazicionit në vendosjen e kontenerëve të rinj në gjithë territorin e Bashkisë Kuçovë .

Përfundimi i punimeve të shërbimit, do të jetë me datë **15 / 02 / 2023** .

Për njësinë administrative Perondi punimet e shërbimit do të fillojnë më datë **16 .04. 2019 (kur të përfundojë kontrata aktuale për këtë njësi)** , ose në raste të diktuara nga rrethana të tjera ligjore apo të interesit publik përpara këtij planifikimi .

Përfundimi i punimeve/shërbimit sipas kërkesës së DST dhe ofertës së OE për këtë njësi administrative (Perondi) është 36 muaj dhe fillon nga data **16 .04 . 2019**, ndërkohe që shërbimi do të kërkohet të zhvillohet në përpjestim me periudhën e mbetur të kontratës për njësitë e tjera administrative.

3.2 Autoriteti Kontraktor do të përshtasë periudhën e përfundimit të shërbimit për njësinë administrative Perondi në përpjestim me muajt e mbetur të kontratës për njësitë e tjera administrative në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate si dhe nenit 33 të LPP-se.

Neni 4: Gjuha e Kontratës


4.1 Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

Neni 5:

Qëllimi

5.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për Shërbimetë prokuruarë me anë të procedurës së hapur.

5.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë,



janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

5.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

5.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 6: Përkufizime

6.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

6.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

6.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.


6.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

6.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

6.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

6.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

6.8 “Termit e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.



Neni 7:

Hartimi i Kontratës

7.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit .

7.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 8:

Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

8.1 Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

8.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

8.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndërtimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.



8.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues .

Neni 9:

Informacioni Konfidencial

9.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

9.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtton ruajtjen e kofidencës sic thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.



Neni 10:

Prona Intelektuale

10.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

10.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

10.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 11:

Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

11.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.

11.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

11.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

11.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrijë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe



marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 12:

Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

12.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.

12.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

12.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 13:

Specifikime dhe Skicime

13.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatiti të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Autoritetin Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.

13.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjëse përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 14:

Lejet dhe Liçensat



14.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 15:

Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

15.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.

15.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.



15.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikim ekuivalente ose kualifikime të kerkuara sipas legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe manaxhimin të integruar të mbetjeve.

15.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

Neni 16:

Vendndodhja

16.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuar sipas pikave të grumbullimit të plehrave të caktuara në hartat bashkalidhur, dst dhe në kontratë.

16.2 Nëse nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

Neni 17:

Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

17.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

17.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

Neni 18:



Çmimi i Kontratës

18.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe pranuar në tender.

Neni 19:

Afatet e Pagesës

19.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë specifkohet në kontratë.



19.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim .

19.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

19.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.

19.5 Data e pagesës do të jetë dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

Neni 20:

Vonesa në Bërjen e Pagesës


20.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamatën që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përçindja e kamatës parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.

20.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dëm. Nëse kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

Neni 21:

Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

21.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.



Neni 22:

Forca Madhe



22.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontratës, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

22.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme, jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

22.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 23:

Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit


23.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

23.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.

23.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japë kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

23.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore sipas zakoneve dhe praktikës së ndjekur nga ky Autoritet në rastet e ngjashme/ njëjta me objektin e kësaj kontrate .

23.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të miratuar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.



Neni 24:

Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

24.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 25:

Negociatat dhe Amendamentet

25.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit përveç atyre të lejuara në këtë kontratë dhe legjislacioni në fuqi.

25.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

25.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 26:


Ndryshimi i Porosisë

26.1 Autoriteti Kontraktor rezervon në çdo moment të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Neni 27:

Ndërprerja për Mosplotë

27.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:



a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet në tërësi brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,

b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër thelbësor të kontratës.

27.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 28:

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

28.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

28.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 29:

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

29.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

29.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

29.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.


29.4 Çdo veprim administrativ i Autoritetit Kontraktor, për të cilin kontraktori nuk është dakord ka të drejtën t'i drejtohet menjëherë Gjykatës Administrative.

Neni 30:

Nënkontrata

30.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

30.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontratojë pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës.



Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

30.3 Çdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.

30.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizojë një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nënkontraktuesin si dhe punimet konkrete që do të japë me nënsipërmarrje.

30.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 31:

Transferimi i të Drejtave

31.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

Neni 32:

Sigurimi i Kontratës

32.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates 10% në shumën dhe formën e kërkuar, me vlerë: **11,273,841** (njëmbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzetë e një) lekë.

32.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

32.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

Neni 34:

Baza Ligjore

34.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislativës shqiptare në fuqi.



Neni 35:

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

35.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

35.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 36:

Përfaqësimi i Palëve

36.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

36.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

36.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 37:

Lajmërimet


37.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

37.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 38:

Llogaritja e Afateve

38.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.



Neni 39:

Dokumentat e Kontratës

39.1 Dokumentat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e kontratës:

- a. DST e hartuara nga Bashkia Kuçovë, Kushtet e Pergjithshme dhe të Veçanta
- b. Preventivat e Ofertuesit
- c. Deklaratat e ofertuesit
- d. Oferta dhe gjithë dokumentacioni i Kontraktorit
- e. Procesverbalet dhe dokumentacioni i procedurës së prokurimit, dhe vendimet e KPP-së.
- f. Njoftimi i Fituesit si dhe gjithë dokumentacioni i administruar nga njësia e prokurimit për këtë procedurë prokurimi .

Neni 40:

Dispozita e Fundit

40.1 Kjo kontratë hartohet ne 6 (gjashtë) kopje, nga të cilat 5 (katër) kopje i mban Autoriteti Kontraktor dhe 1 (një) kopje Kontraktuesi .

40.2 Kontrata quhet e vlefshme vetëm pasi të jetë nënshkruar nga të dyja palët .


PALËT KONTRAKTUESE

Autoriteti Kontraktor

BASHKIA KUÇOVË

KRYETARI

Selfo KAPLLANI



Kontraktuesi

Viola Green shpk

ADMINISTRATOR

Marsel SHEGA